

A është besimi në evolucionin i domosdoshëm për progresin shkencor?

Ideja se dituria mbi evolucionin dhe të kuptuarit e tij e rrit progresin shkencor është shumë e diskutueshme. Filip Skell [Philip Skell], një ish-Profesor i Kimisë në Universitetin Shtetëror të Pensilvanisë, komentoi,

Kohët e fundit pyeta më shumë se 70 kërkues të shquar shkencorë nëse ata do ta kishin kryer punën e tyre ndryshe po ta kishin ditur se teoria e Darvinit ishte e gabuar. Përgjigjet ishin të gjitha të njëjta: Jo. Gjithashtu shqyrtova zbulimet biologjike të famshme të shekullit të kaluar: zbulimin e helikoidës dyfishe; karakterizimin e ribozomit; hartimi i gjenomeve; kërkimet mbi ilaçet dhe reaksionet e mjekimeve; përmirësimet në prodhimin e ushqimit dhe higjienën; zhvillimi i operacioneve të reja, e të tjera. Madje edhe u bëra pyetje biologëve që punojnë në zonat ku dikush mund të priste se paradigma e Darvinit kishte kërkimin shkencor më dobiprurës, të tillë si shfaqja e rezistencës ndaj antibiotikëve dhe pesticideve. Këtu, si edhe kudo tjetër, unë gjeta se teoria e Darvinit nuk ka dhënë udhëzime të dukshme, por ishte futur, pas zbulimeve të mëdha, si një shpjegim tregues interesant.¹

Në mënyrë të ngjashme, Dr. Mark Kirshner [Marc Kirschner], Përgjegjësi dhe njëkohësisht themeluesi i Departamentit të Biologjisë së Sistemeve në Shkollën Mjekësore të Harvardit, shënoi, ‘Në fakt, gjatë 100 viteve të fundit, pothuajse e gjithë biologjia ka përparuar në mënyrë të pavarur nga evolucionin, përveç vetë biologjisë evolucioniste. Biologjia molekulare, biokimia, fiziologjia, nuk e kanë marrë fare në konsideratë evolucionin.’² Disa madje kanë sugjeruar se besimi në evolucionin e ka penguar progresin shkencor. Heribert Nilsson, i cili ishte Profesor i Botanikës dhe Drejtor i Institutit Botanik Suedez në Universitetin e Lundit, argumentoi,

Rezultati përfundimtar i të gjitha kërkimeve të mia shkencore dhe i diskutimeve të mia është

Kapitulli 9

se duhet të heqim dorë tërësisht nga teoria e evolucionit, për shkak se ajo gjithnjë shpie në kontradiksione ekstreme dhe në pasoja pështjelluese kur testohet kundrejt rezultateve empirike të kërkimeve shkencore ...

Për më tepër: përfundimi im tjetër është se, duke qenë larg prej të qenët një shkollë mendimi natyror–filozofik e parrezikshme, teoria e evolucionit është një pengesë e ashpër për kërkimin shkencor biologjik. Ashtu siç tregojnë shumë shembuj, ajo aktualisht shmang nxjerrjen e përfundimeve logjike nga qoftë edhe një komplet material eksperimental. Për shkak se gjithçka duhet të përkulet që të përshatet me këtë teori spekulative, nuk mund të zhvillohet një biologji e saktë.³

Sipas Profesorit Lui Bonor [Louis Bounoure], ish Presidenti i Shoqërisë Biologjike të Strasburgut dhe Drejtor i Muzeut Zoologjik të Strasburgut, ‘Kjo teori nuk ka ndihmuar aspak në përparimin e shkencës. Është e padobishme.’⁴ Sipas Profesorit de Beer, teoria e përsëritjes së Hekelit ‘pati përpjekje të vajtueshme mbi përparimin biologjik’⁵ dhe, sipas Profesorit Blekshmidt [Blebschmidt], ajo e shpuri mbrapsht njëqind vjet embriologjinë e vërtetë shkencore.⁶ Një shembull i mirë i asaj se ku e ka penguar përparimin mjekësor të menduarit evolucionist është besimi në ‘organet rurimentare’. Funkzionet e tyre nuk u kuptuan për vite të tëra, për shkak se ato u presupozuan se ishin rudimentare dhe një bashkëprodukt i historisë sonë evolucioniste. Në rastin e ‘timusit rudimentar’, ajo shpuri në trajtimin e timusave të fëmijëve me radioterapi, me rezultate tragjike. Për shumë vjet, bajamet mendoheshin se ishin rudimentare dhe shpesh hiqeshin që në fëmijëri; por tani dihet se ato janë pjesë e sistemit tonë imunitar. Heqja e tyre rezulton në një rritje katërfish të riskut për të zhvilluar sëmundjen e Hodgkin, për shembull.⁷ Në mënyrë të ngjashme, besimi në ADN-në ‘hedhurinë’ e ka shtyrë përparimin në të kuptuarit e gjenetikës. Sigurisht, nëse evolucionit nga ‘molekulat te njeriu’ do të ishte i vërtetë, ne do të vëzhgonim vazhdimisht në natyrë një proces krijues me fuqi vigane, të tillë që do të kishte një ndikim të pamasë mbi kërkimin shkencor dhe zhvillimin—në kimi, biologji, mjekësi dhe bujqësi. Në vend të kësaj, në shkencën reale praktike, ai duket se është pa lidhje.

Përveç kësaj shpesh është debatuar se mësimi i kreacionizmit ose i ‘projektimit inteligjent’ nëpër shkolla si gjithçka tjetër, përveçse si ‘mite fetare’ e kërcënon përparimin shkencor. Megjithatë, faktet e historisë, tregojnë një histori tjetër. Sipas Profesorit Stenli Xhaki [Stanley Jaki], *epoka shkencore* nisi si rezultat i besimit Kristian në një Krijues.⁸ Një nga themeluesit e hershëm të shkencës moderne

A është besimi në evolucionin i domosdoshëm për progresin shkencor?

ishte astronomi i shekullit të shtatëmbëdhjetë, Johannes Kepler. Në Përmbledhjen e tij për *Astronominë e Kopernikut (Epitome Astronomia e Copernicanae)*, ai shkroi se si puna e tij shkencore ishte nxitur nga ‘mirëbesimi më i lartë në veprat e dukshme të Perëndisë’, dhe shpesh i zbulonte reflektimet e tij mbi metodën shkencore me citime biblike mbi urtësinë, fuqinë dhe lavdinë e Perëndisë.⁹ Galileo shkroi se ‘libri i natyrës është një libër i shkruar nga dora e Perëndisë në gjuhën e matematikës’¹⁰ dhe iu referua Krijuesit hyjnor si një ‘mjeshtër’ dhe një ‘arkitekt’, koncepte që e frymëzuan atë të kryente eksperimente për të mësuar për krijimin e Perëndisë. Duke besuar se mendja njerëzore gjithashtu është vepër e Krijuesit të tij, ai e ndoqi me mirëbesim kërkimin e tij shkencor duke pasur pritjen se mendja e krijuar nga Perëndia ishte e aftë ta kuptonte të paktën diçka nga pjesa tjetër e Krijimit të Perëndisë. Sipas Galileos, ishte ky besim Kristian se parimet e gjithësisë ishin të pazbulueshme që e bëri Kopernikun të postulonte teorinë e thjeshtë se toka rrotullohej përreth diellit.¹¹ Matematikieni i shekullit të shtatëmbëdhjetë Rene Dekarti [Rene Descartes], të cilit shpesh i referohen si ‘babai i matematikës moderne’, në mënyrë të qartë e nxori kuptimin e tij për ligjet e lëvizjes nga kuptimi që kishte për Perëndinë. Në librin e tij *Bota (Le Monde)*, ai argumentoi, ‘Këto dy rregulla në mënyrë të dukshme vijnë vetëm pas atij se Perëndia është i pandryshueshëm, dhe se ai duke vepruar në të njëjtën mënyrë gjithmonë, prodhon gjithnjë të njëjtin efekt.’¹² Sipas Profesorit Jaki, për Robert Boilin [Robert Boyle], ‘doktrina dhe besimi në Krijuesin përfaqësonin vetë themelin e arsytimit të shëndetshëm për botën’, dhe Isak Njutoni [Isaac Newton] ‘në mënyrën më të qartë e nënshkroi nocionin e një Krijimi një herë e përgjithmonë si i vetmi sistem i shëndetshëm i filozofisë natyrore’.¹³ Në një ese të shkruar për Shoqërinë Mbretërore, Xhon Mainard Keines [John Maynard Keynes] tha për Njutonin se ‘ai e konsideronte gjithësinë si një kriptogram të vendosur nga i Plotfuqishmi’.¹⁴ Vetë Njutoni, duke komentuar për vëzhgimet e tij astronomike, shkroi, ‘Ky më i bukuri sistem i diellit, planetëve dhe kometave, mund të buronte vetëm prej këshillës dhe sundimit të një qenieje inteligjente dhe të plotfuqishme.’¹⁵

Që besimi i këtyre kreacionistëve dhe të tjerëve si ta, siguronte bazën për shkencën moderne u pranua nga antropologu i shquar dhe historiani i shkencës, Profesi Loren Eisli [Loren Eiseley]:

... filozofia e shkencës eksperimentale ... i nisi zbulimet e saj dhe i përdori metodat e saj në besimin, jo në njohurinë se ajo po merrej me një gjithësi racionale të kontrolluar nga

Kapitulli 9

një krijues që nuk vepronte me kapriço e as nuk ndërhynte te forcat që Ai i kishte vënë në veprim ... Sigurisht është një nga paradokset më kurioze të historisë së shkenca, që nga ana profesionale ka të bëjë pak me besimin, ia detyron fillimet e saj një veprimi besimi se gjithësia mund të interpretohet në mënyrë të arsyeshme, dhe se shkenca sot mbahet prej atij supozimi.¹⁶

Këta burra ishin shkencëtarë të vërtetë, në kuptimin modern. Ashtu si shkencëtarët që mbështesin krijimin sot, ata i konsideronin ligjet natyrore si përshkrime të mënyrës se si e mban Perëndia krijimin e tij në një drejtim të rregullt dhe të përsëritshëm. Të frymëzuar nga kjo, ata u morën me vëzhgime dhe eksperimente që ta kuptonin dhe ta shpjegonin gjithësinë lidhur me mekanizmat e testueshëm.

Në vend që besimi të krijimi ta pengonte përparimin shkencor, është e qartë se besimi i këtyre shkencëtarëve të hershëm kishte shkaktuar që vepra e tyre të drejtohej në rrugë të frytshme. Sipas opinionit tonë, mohimi i kohëve të fundit i besimit Kristian prej shumë vetave, dhe ndjekja në mënyrë laike e shkencës, ka shpënë në të kundërtën e kësaj. Tani një sasi e pamasë kohe dhe parash harxhohen me përpjekjet për të shpjeguar origjinën e gjithësisë dhe të jetës, diçka që ndoshta është përjashta mundësive të njohurisë shkencore.

Shënimet

- 1 **Philip S. Skell**, 'Why Do We Invoke Darwin? Evolutionary Theory Contributes Little to Experimental Biology', *The Scientist*, 19/16 (2005), fq. 10.
- 2 Cituar nga **Peter Dizikes**, 'Missing Links', *Boston Globe*, 23 October 2005, te: boston.com/news/globe/ideas/articles/2005/10/23/missing_links/?page=1.
- 3 **Heribert Nilsson**, përkthyer dhe cituar në **Werner Gitt**, *In the Beginning Was Information* (Bielefeld: Christliche Literatur-Verbreitung, 1997), fq. 105–106.
- 4 Cituar në *The Advocate*, 8 March 1984, fq. 17.
- 5 **Gavin de Beer**, *Embryos and Ancestors* (3rd edn.; London: Oxford University Press, 1958), fq. 172.
- 6 Cituar në **Joachim Vetter**, 'Hands and Feet: Uniquely Human Right from the Start', *Creation*, 13/1 (1990), fq. 16–17, te: creationontheweb.com; answersingenesis.org.
- 7 **Lawrence Galton**, cituar në **Jerry Bergman** and **George Howe**, 'Vestigial Organs' Are Fully Functional (St Joseph, MO: Creation Research Society, 1990), fq. xi.
- 8 **Stanley Jaki**, *Science and Creation* (Edinburgh: Scottish Academic Press, 1986).
- 9 Po aty. fq. 268.
- 10 **Rodney Stark**, *For the Glory of God: How Monotheism Led to Reformations, Science, Witch-hunts and the End of Slavery* (Princeton: Princeton University Press, 2003), fq. 165.

A është besimi në evolucionin i domosdoshëm për progresin shkencor?

- 11 **Jaki**, *Science and Creation*, fq. 276–279.
- 12 Cituar po aty. fq. 281.
- 13 Po aty. fq. 285, 287.
- 14 **John Maynard Keynes**, cituar në **Stark**, *For the Glory of God*, fq. 173.
- 15 Cituar në **Dinesh D'Souza**, *What's So Great about Christianity* (Washington DC: Regnery Publishing, 2007), fq. 97.
- 16 **Loren Eiseley**, *Darwin's Century: Evolution and the Men who Discovered It* (New York: Anchor Books, 1961), fq. 62.